



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:918270
Datë: 18.02.2025
Numri i dokumentit: 06860147

Ac.nr.3179/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Naime Ahmeti dhe Adnan Konushevci, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.H nga Prishtina, rruga “SH”, p.nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Betim Shala, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Naim Krasniqi avokat shtetëror në Avokaturën Shtetërore të Republikës së Kosovës në Prishtinë, për përmbushje të obligimeve kontraktuese, pagimin e borxhit dhe kompensimin e fitimit të humbur, duke vendosur sipas ankesës së paditësit dhe ankesës së të paditurës, të paraqitura kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.****/21 të datës 15.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. *REFUZOHET pjesërisht e pabazuar* ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë dhe *në tërësi e pabazuar* ankesa e paditësit I.H nga Prishtina, rruga “SH”,p.nr., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.****/21 të datës 15.02.2022 pjesërisht në pikën I (një) të dispozitivit në pjesën me të cilën është detyruar e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, që paditësit në emër të borxhit për mos pagimin e shërbimeve të kryera për periudhën kohore prej 01 Janar e deri me 31 Qershor 2011, të cilat rrjedhin nga kontrata me nr.**-*** e datës 20 Janar 2011, t’ia paguaj shumën prej 9,000.00 euro, me kamatë siç e paguajnë bankat vendore për deponimet në kursim pa destinim të caktuar në kohëzgjatje mbi 1 vit, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjer në pagesën definitive , VËRTETOHET.

II. *APROVOHET pjesërisht e bazuar* ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.****/21 të datës 15.02.2022

pjesërisht në pikën I (një) të dispozitivit në pjesën me të cilën është detyruar e paditura që paditësit në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore 01 Korrik 2011 e deri me 31 Dhjetor 2011, t'ia paguaj shumën prej 9,000.00 euro (duke e llogaritur shumën e tërësishme të dëmit prej 18,000.00 euro, dhe pika III (tre) e dispozitivit përkitazi me shpenzimet e procedurës, ashtu që në këtë pjesë çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.****/21 të datës 15.02.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit I.H nga Prishtina dhe e ka detyruar të paditurën Qeveria e Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, që paditësit t'ia paguaj shumën prej 9,000.00 euro në emër të borxhit për mos pagimin e shërbimeve të kryera për periudhën kohore prej 01 Janar e deri me 31 Qershor 2011, të cilat rrjedhin nga kontrata me nr.**-*** e datës 20 Janar 2011, si dhe shumën prej 9,000.00 euro në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore nga 01 Korrik 2011 e deri me 31 Dhjetor 2011, gjithsej shumën prej 18,000.00 euro, me kamatë siç e paguajnë bankat vendore për deponimet në kursim pa destinim të caktuar në kohëzgjatje mbi 1 vit, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e gjer në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit me detyrim. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Qeveria e Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit t'ia paguaj shumën prej 1,730.50 euro, të cilat do ti paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë paditësi nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e atakuar aktgjykimin vetëm përkitazi me kamatën e gjykuar, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovjë ankesën si të bazuar, të ndryshohet aktgjykimi në pjesën e ankimuar ashtu që të detyrohet e paditura që të paguaj kamatën prej 8 %, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë datë 17.05.2012 apo nga data e marrjes së aktgjykimit të parë dt. 08.06.2017.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë edhe paditura Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë është pjesërisht e bazuar, ndërsa ankesa e paditësit I.H nga Prishtina, rruga "SH", p.nr., është në tërësi e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi I.H nga Prishtina, me datë 17.05.2012 në gjykatën e shkallës së parë nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, për përmbushjen e obligimeve kontraktuese, pagimin e borxhit dhe kompensimin e fitimit të humbur, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit me aktgjykimin C.nr. 1233/12 të datës 08.06.2017, e kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.***/2018 të datës 19.08.2021, e ka pranuar ankesën e të paditurës ashtu që e ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1233/12 të datës 08.06.2017 dhe çështjen e ka kthyer në procedim të serishëm.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.****/21 të datës 15.02.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata ka theksuar se nga provat e administruara ka gjetur se në mes të ndërgjyqësve është krijuar marrëdhënia juridike në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të LMD-së me kontratën e lidhur në mes të paditësit dhe Implementueses së Projektit, këtu e paditura Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila kontratë ka prodhuar efektet e saj ashtu që ka krijuar të drejta dhe detyrime për palët dhe pala paditëse ka përmbushur obligimet e tij deri në momentin kur e paditura, ka shkëputur kontratën njëanshëm, me arsyetimin se sekretari i përgjithshëm paraprak nuk ka qenë i autorizuar të nënshkruaj kontratën me paditësin, ndërkaq pala e paditur për kohën sa paditësi dhe anëtarët e projektit kanë kryer shërbimet siç edhe janë dakorduar me kontratën e *-*** të datës 21.01.2011, e njëjta nuk e ka përmbushur detyrimin e saj, ngase në rastin konkret ka dështuar që të bëjë pagesën ashtu siç edhe janë dakorduar palët kontraktuese, për periudhën 6 mujore, të cilën kontratë gjykata e ka pranuar si valide, edhe pse në mes palëve nuk ka qenë kontestuese ekzistimi i kontratës, mirëpo kontestuese ka qenë vlefshmëria e saj, ngase e paditura pretendon që kontrata është lidhur nga personi i paautorizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili në cilësinë e drejtorit të projektit e ka lidhur kontratën me paditësin. Gjykata më tej ka arsyetuar se ka gjetur se shërbimet e konsulencës nga ana e paditësit dhe personave të angazhuar në projekt janë kryer me rregull, deri në shkëputjen e kontratës njëanshëm dhe se nuk ka pasur vërejtje deri në atë kohë lidhur me shërbimet e dhëna të konsulencës nga ana e të paditurës, ndërsa gjykata ka vlerësuar se personi atë kohë Drejtor i Projektit, ka lidhur kontratë në cilësinë e drejtorit të projektit lëndor të kontratës, e jo në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, siç është pretenduar nga pala e paditur, ndërsa në anën tjetër e paditura nuk ka ofruar prova se i ka përmbushur detyrimet kontraktuese në raport me paditësin për shërbimet e kryera sipas kontratës në periudhën kohore prej 6 muajsh nga muaji janar deri

qershor 2011. Andaj nga të lartcekurat duke ju referuar dispozitës së nenit 124 lidhur me nenin 262 të LMD-së e ka obliguar të paditurën që paditësit në emër të përmbushjes së kontratës për shërbimet e kryera të konsulencës t'ia paguaj shumën prej 9,000.00 Euro.

Mënyrën e vendosjes përkitazi me fitimin e humbur gjykata e ka arsyetuar se me shkeputjen e njëanshme të kontratës pa paralajmërim nga ana e të paditurës, paditësit i është shkaktuar dëmi pasiqë arsyeja e shkeputjes është e pabazë, ngase nënshkruesi i kontratës aso kohe, e ka nënshkruar kontratën në cilësinë e drejtorit të projektit, e jo në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të MKRS-së, siç pretendon e paditura dhe meqë kontrata është lidhur për periudhën 1 vjeçare (Janar-Dhjetor 2011), ndërsa shkeputja e kontratës është bërë pas 6 muajve prej lidhjes së saj, pa paralajmërim paraprak për arsye e cila nuk është parashikuar si arsye e shkeputjes së kontratës, edhe pse të njëjtat kontrata janë pranuar edhe nga Banka Botërore si financuese e projektit, andaj në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se kemi të bëjmë me fitim të munguar, ngase realizimi i tërësishëm i kontratës deri në dhjetor 2011, është penguar nga e paditura, andaj duke ju referuar dispozitës së nenit 189 të LMD-së e ka detyruar të paditurën që paditësit në emër të fitimit të humbur për periudhën kontestuese t'ia paguaj shumën prej 9,000.00 euro. Lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e ka bazuar në ekspertizën financiare, të cilës i ka falur besimin, duke e vlerësuar si adekuate dhe e mbështetur në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për kamatën gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 277 të LMD-së ndërsa për shpenzimet e procedurës i është referuar nenit 449, 452 dhe 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi) është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, ku gjykata e shkallës së parë edhe ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes, të cilat kanë mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pjesën e vërtetuar nga Gjykata e Apelit është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, për bazueshmërinë e kësaj pjese të kërkesëpadisë, ku në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi i ankimuar në pjesën e vërtetuar, është i përfshirë në konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se pjesa e kërkesëpadisë së paditësit është e bazuar në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi), për arsye se gjykata të gjitha faktet vendimtare të çështjes, i ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në procedurën e provave gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me dt. 20.01.2011 ka lidhur kontratë me të paditurën duke krijuar një raport kontraktor, ku si nënshkrues i kontratës ka qenë paditësi në cilësinë e konsulentit si dhe Drejtori i Projektit S.M në cilësinë e klientit. Kjo kontratë është lidhur për një periudhë 1 vjeçare (Janar-Dhjetor 2011) , në të cilën është përcaktuar edhe mënyra e pagesës për shërbimet e kryera, poashtu është vërtetuar fakti se e paditura në muajin qershor gjegjësisht me dt. 08.06.2011 e njofton paditësin për shkëputjen e kontratës me pretendimin se kontrata është nënshkruar nga personi i paautorizuar, ngase në kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate personi zyrtar ka qenë i përfshirë në procesin zgjedhor për zgjedhjet nacionale, e gjithashtu është vërtetuar edhe fakti se paditësi për periudhën e sipërcekur pra nga muaji janar deri në muajin qershor i ka kryer shërbimet e kontraktuara për çka edhe me parashtresën e dt. 03.08. 2011 i është drejtuar të paditurës për kryerjen e pagesës për punët e kryera. Në anën tjetër e paditura dhe përkundër faktit se e ka kontestuar se shërbimet nuk janë kryer nga ana e paditësit, megjithatë nuk ka ofruar ndonjë provë për këtë apo edhe në të kundërtën nuk i ka bërë ndonjë vërejtje paditësit për shkak të mos kryerjes së shërbimeve ashtu siç pretendon e njëjta, andaj vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë dhe përfundimi i nxjerrë nga vlerësimi i tyre për pjesën e kërkesëpadisë e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit u vërtetua është i pranueshëm edhe për këtë gjykatë.

Si rezultat i gjendjes faktike të vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë në pjesën e vërtetuar të aktgjykimit, drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë është aplikuar edhe e drejta materiale. Me dispozitën e nenit 124 të LMD-së i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko civil shprehimisht parashihet se: *“Në kontratat dypalëshe kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër mundet në qoftë se nuk është caktuar diçka tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushte të parashikuara në nenet e më pastajme, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë në qoftë se zgjidhja e kontratës lind sipas vetë të drejtës, e sidoqoftë ka të drejtë t'i kompensohet dëmi”*, ndërsa me dispozitën e nenit 262 të të njëjtit ligj përcaktohet se : *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij. Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonon me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale në pjesën e vërtetuar të aktgjykimit e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike .

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi), prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Drejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe sa i përket kamatës së gjykuar në raport me pjesën e kërkesëpadisë e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi), pasi që kamata është gjykuar në përputhje me dispozitën ligjore të nenit 277 të LMD-së, andaj edhe pretendimet ankimore të paditësit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkitazi me kamatën e gjykuar, për këtë pjesë të dispozitivit është e pa bazuar.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rigjykim sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, (pjesërisht në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar) përkitazi me fitimin e humbur, është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160.3 dhe 4 të LPK-së, pasi që kjo pikë e dispozitivit të aktgjykimit është e paqartë, kontradiktore me vetvete dhe me arsyetimin e aktgjykimit të atakuar dhe si e tillë është e pa ekzekutueshme, e kjo paraqet shkelje të dispozitës së nenit 160.3 të LPK-së. Kjo për faktin se dispozitivi i aktgjykimit në këtë pikë të ankimuar është i paqartë, ngase gjykata e shkallës së parë e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguajë në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore 01 Korrik 2011 e deri me 31 Dhjetor 2011, shumën prej 9,000.00 euro duke mos precizuar se ku konsiston fitimi i humbur. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160.4 të LPK-së, qëndrojnë nga shkak se aktgjykimi i ankimuar në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rigjykim sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato arsye të cilat janë dhënë janë të mangëta dhe të paqarta. Kjo ngase gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar fare vendosjen përkitazi me këtë kërkesë, pra se ku konsiston fitimi i humbur dhe si gjykata e shkallës së parë ka gjykuar lartësinë e dëmit për këtë formë të dëmit. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit si arsye për këtë formë të kompensimit i është referuar ekspertizës financiare- aktuale, mirëpo nuk ka dhënë asnjë arsye se ku konsiston fitimi i humbur, madje pa dhënë asnjë arsye edhe përkitazi me ekspertizën dhe pse të njëjtës i ka falur besimin me rastin e vendosjes.

Për pjesën e kthyer në rigjykim, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të konvokoj seancën e shqyrtimit kryesor, për të cilën në mënyrë të rregullt të ftoj palët ndërgjyqëse, të administrojë prova në drejtim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike përkitazi me fitimin e humbur. Me rastin e vendosjes në lidhje me këtë pjesë të kërkesëpadisë, gjykata e shkallës së parë, përveçse ka për obligim që të vërtetoj drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këtë procedurë, duke i vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse si dhe duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm për këto pretendime dhe tek pas sqarimit të të gjitha fakteve, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj për këtë çështje juridike. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së. Në çdo rast

veprimet dhe vendimet e gjykatës duhet të jenë në harmoni me dispozitat ligjore dhe standardet e gjykimit të drejtë.

Gjykata e Apelit aktgjykimin e ankimuar e ka prishur edhe në pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditësit, pa u lëshuar fare në ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se kjo lëndë kontestimore u dashtë që të priset në një pjesë dhe gjykatës së shkallës së parë t'i kthehet në rigjykim, me çka në procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos me rastin e marrjes së aktgjykimit përfundimtar, duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurë dhe dhënies shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.****/2022, me datë 05.02.2025.

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v.